

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DEGËN E DOGANËS, FIER

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Degën e Doganës, Fier me objekt “Mbi zbatimin e legjislacionit doganor” për periudhën 2012-2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 30, datë 31.03.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 13/7, date 31.03.2014 dhe nr. 13/6, datë 31.03.2014, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, i janë dërguar znj. Elisa Spiropali, Drejtor i Përgjithshëm i Doganave, Tiranë dhe z. Dritan Çekani, Kryetar i Degës Doganës, Fier.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga Dega e Doganës Fier, për të gjitha ato praktika doganore të subjektit [REDAKTUAR] të rekomanduara nga KLSH për investigim faturash, të ndërmerren hapat ligjorë, për përlllogaritjen e detyrimeve doganore shtesë, meqenëse nuk ka mundësi verifikimi të faturave, si dhe sektori i borxhit të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për rikuperimin dhe vjeljen e borxhit doganor në shumën 1,999,232 mijë lekë.

2. Nga Dega e Doganës Fier në funksion të implementimit të kërkesave të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, titullari i njësisë, të hartojë politikat, të miratojë dhe monitorojë objektivat e njësisë publike që ai drejton, planet strategjike e vjetore, strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave.

3. Nga Dega e Doganës Fier të merren masa që mallrat e konfiskuara si rezultat kundërvajtjeve doganore në **vlerë 53,300 lekë**, referuar faqes 94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, të dorëzohen në Rezervat Materiale të Shtetit.

4. Nga Dega e Doganës Fier të merren masat për kompletimin e dosjeve të subjekteve që operojnë në fushën e akcizës me të dhënat që përcakton ligji nr. 61/2012, “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, dhe VKM nr. 612/2012 “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit për Akcizat”, të krijohet regjistri aktiveve të qëndrueshme dhe të miratohen akte të brendshme administrative për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve të njësisë sipas kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III -të.

5. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (Departamenti Teknik), lidhur me praktikën doganore me R-7443, datë 15.08.2012, trajtuar në faqen 47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, të merren masa për klasifikimin e saktë tarifor të artikujve të deklaruar në këtë praktikë doganore mbështetur në kompetencat ligjore që gëzon kjo strukturë si dhe të përcaktohen saktë vlerat referuese dhe të përlllogaritet vlera reale e importeve të artikullit “BANANE”, pasi përlllogaritjet janë bërë sikur importohet nga vendet prodhuese pa llogaritur dilerin, magazinimin dhe elementë të tjerë që shtojnë vlerën e produktit për efekt të llogaritjes së detyrimeve doganore.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga Dega e Doganës Fier të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **145,895,944 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Vlera prej **1,749,236 lekë** nga 10 punonjës sipas anekseve nr. 4 - 7, për shpenzime operative të pajustificuara dhe jo në përputhje me kërkesat logjore.

2. Vlera prej **144,146,708 lekë** nga subjektet me detyrime të papaguar si dhe revokimit të vendimeve administrative të nxjerra jo në përputhje me ligjin në mënyrë analitike si më poshtë:

2.1. Vlera prej **108,017,813 lekë** nga 23 subjekte sipas aneksit 3 dhe 3.1 të Raportit si rezultat i revokimit të akteve administrative të nxjerra në shkelje të neneve 256.4, 261.1, 261.2 dhe 273.2 të Kodit Doganor si dhe neneve 87.1/2, 87.1/3 të ligjit “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”.

2.2. Vlera prej **30,916,726 lekë** nga 229 subjekte sipas aneksit 1; 1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.5; 1.6; 1.7 dhe 1.8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit si rezultat i veprimeve jo në përputhje me kërkesat e neneve 34-39; 256.4; 261.1; 261.2 dhe 261.3 të Kodit Doganor; të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të MF “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore...” si dhe të “Protokollit të Origjinës” gjatë procedurave të zhdoganimit të mallrave.

2.3. Vlera prej **4,105,875 lekë** nga 4 subjekte sipas aneksit 2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit si rezultat i veprimeve jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.2; 256.4; 275.1 dhe 287.2/f të Kodit Doganor dhe me përcaktimet në pikën 300.1,2,3 të VKM nr. 205, datë 3.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” gjatë procedurave të regjimeve të përpunimit aktiv.

2.4. Vlera prej **1,106,294 lekë** nga 4 subjekte sipas aneksit 8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit si rezultat i veprimeve jo në përputhje me kërkesat e neneve 287.1 dhe 289.1 të Kodit Doganor gjatë procedurave të vendimmarrjes.

C. MASA ADMINISTRATIVE

Bazuar në nenet 275.1 dhe 287.2/f të Kodit Doganor, Dega e Doganës Fier të aplikojë penalitetet me gjobë në masën nga 50,000 lekë deri në 200,000 lekë, për 2 (dy) agjensi doganore:

1. Agjensinë doganore [REDAKTUAR] për problemet e konstatuara në përpilimin e DAV, pasi janë deklaruar dhe zhdoganuar artikuj të keqklasifikuar në kod tarifor me pasojë shmangien nga detyrimet doganore në shkelje të neneve 256.2, 256.4, 261.1 dhe 261.2 të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë. (*Trajtuar në faqet 14; 21-23; 29 dhe 40-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2. Agjensinë doganore [REDAKTUAR] për problemet e konstatuara në përpilimin e DAV, pasi janë deklaruar dhe zhdoganuar me MSABE artikuj pa certifikatë EUR.1 si dhe janë deklaruar dhe zhdoganuar artikuj të keqklasifikuar në kodin tarifor me pasojë shmangien nga detyrimet

doganore në shkelje të neneve 256.2, 256.4, 261.1 dhe 261.2 të Kodit Doganor të RSh. (Trajtuar në faqet 55 dhe 60-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

D. MASA DISIPLINORE

Bazuar në VKM nr. 205, datë 13.4.1999 të ndryshuar me vendimin nr. 686, datë 02/11/2005, për shkeljen e dispozitës nr.16.1 germa “a” dhe “ë”, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të propozojë në Komitetin Disiplinor fillimin e procedurës për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

“Ulje një shkallë në kategori dhe transferim nga pozicioni i punës 6 muaj”, dispozita 18.1.4 germa “ç”, per 3 (tre) punonjes.

1. Për [REDAKTUAR] me detyrë specialist në DPD, në cilësinë e ish-përgjegjës regjime/akcizë në Degën e Doganës Fier, për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 15.14 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore, në lidhje zbatimin e procedurave të ligjit nr. 61, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në RSh” dhe VKM nr. 612 “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit për Akcizat”.

2. Për [REDAKTUAR] me detyrë doganier klasifikim/vlerë, për problemet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 15.13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore, në zhdoganimin e mallrave në shkelje të neneve 261.1, 261.2, 33-37 të Kodit Doganor.

3. Për [REDAKTUAR] me detyrë financiar në Degën e Doganës Fier, për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 14.7 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore; të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSh”; të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; të pikës 1, kapitulli III, të VKM Nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” dhe të Udhëzimit nr. 48, datë 08.12.2009 të MF “Për rregullat e shpërblimit të personelit doganor nga të ardhurat që realizohen nga sanksionet e shkeljeve doganore”, pika 9 “Miratimi përfundimtar”.

“Vërejtje me paralajmërim”, dispozita 18.1.4, germa “a” per 1 (nje) punonjes.

1. Për [REDAKTUAR] me detyrë doganiere regjime/përrjashtime, për problemet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 15.19 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore, për problemet e konstatuara në regjimet ekonomike të përpunimit aktiv dhe të lejimit të përkohshëm në shkelje të neneve 256.2, 256.4, 275.1 të Kodit Doganor.

- Për të meta dhe mangësitë e konstatuara, të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk rekomandohet masë për 6 ish-punonjësit e cituar në RPA, për arsye se ata i kanë shkëputur marrëdhëniet me sistemin doganor.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Agron Opari, p/grupi, Hekuran Avdulaj, Din Zeneli, Marvin Karalli, më tej u shqyrtua nga Kryeauditues z. Albert Thoma, Drejtori i Drejtorisë

Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit znj. Albana Agolli si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm, znj. Luljeta Nano.

Mbi zbatimin e rekomandimeve:

Dega e Doganës, Fier me shkresën nr. 944/1, datë 15.04.2014 ka kthyer përgjigje për zbatimin e rekomandimeve nga ku rezulton se janë vlerësuar dhe janë marrë masat përkatëse për zbatimin e të gjitha masave organizative të propozuara, të gjitha masave për shpërblim dëmi në shumën 145,895,944 lekë dhe të gjitha masave administrative e disiplinore.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT